



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:180743

Datë: 16.04.2024

Numri i dokumentit: 05580925

C.nr. 1001/19

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil, me gjyqtarin Besnik Shala, në çështjen juridike kontestimore të paditësve R.G, Z.G dhe M. G të gjithë nga fsh. K, Komuna e P të cilët i përfaqëson av. Q.A nga P, kundër të paditurës Q.R.K – Ministria e Punëve të Brendshme të cilën e përfaqëson A.Sh, me bazë juridike kompensim dëmi vlera e kontestit 134.000,00 euro, në prezencën e të autorizuarit të palës paditëse dhe në mungesë të autorizuarit të paditurës, pas seancës se shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 26.03.2024, ndërsa me datë 16.04.2024, përpiloj këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **REFUZOHET** kërkesëpadia e paditësve 1.R.G, 2.Z.G, 3.M.G – D, të gjithë nga fsh.K, Komuna e P, ashtu që DETYROHET, e paditura Q.R.K – M e P të B, që paditësve ti ia kompensojë dëmin material dhe jo material dhe atë për paditësin R.G kërkojmë shumën prej 98,000.00 € (nëntëdhjetë mijë euro) për djegëjen e shtëpisë dhe orendive brenda saj. Për djegëjen e veturës të markës Ford tipit Galxy me targa SG – 436686, të shtetit të Zvicrës, në vlerë prej 6,000.00 € (gjashtë mijë euro) sipas çmimit të tregut. Për paditësen Z.G në emër të dëmit jo material për shkak të dhimbjeve fizike të intensitetit të lartë, për shkak të lëndimeve të pësuar, kërkojmë shumën prej 10,000.00 € (dhjetë mijë euro). Për paditësen M.G.D emër të dëmit jo material, për shkak të pësimit të frikës primare dhe sekondare kërkojmë shumën prej 10,000.00 € (dhjetë mijë euro), me kamatë ligjore prej 8% nga data 05.05.2022 e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së aktvendimit e nën kërcënimin e përmbartimit me dhunë në tërësi si e pabazuar.
- II. **Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.**

A r s y e t i m

Paditësit përmes të autorizuarit të tyre pranë kësaj gjykate kanë parashtruar padi, kundër të paditurës, me bazë juridike kompensim dëmi vlera e kontestit 134.000,00 euro, e ku në seancën e datës 17.11.2021, është bërë rregullimi i padisë në kuptimi subjektiv ku si palë paditëse kanë mbetur paditësit R.G, Z.G dhe M.G.D, ndërsa për paditësit e tjerë është konstatuar e tërhequr padia. Gjithashtu si palë e paditur ka qenë edhe K Sh.A mirëpo pala paditëse në seancën e datës

17.11.2021 ka tërhequr padinë ndaj të njëjtës, ndërsa me parashtresën e datës 25.01.2024, është bërë precizimi i kërkesëpadisë.

I autorizuari i paditësve me padi, gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: me administrimin e provave u vërtetua se paditësve me dt. 18.08.2016, iu është djegur shtëpia me të gjitha orënditë të cilat ishin brenda saj. Iu janë djegur dy vetura, me të dhëna të specifikuara si në padi. E po ashtu kanë pësuar dëm jo material edhe paditësja Z.G dhe M.G.D, të cilat gjendeshin në shtëpi në momentin e djegies se shtëpisë. Në lidhje me këtë çështje siç shihet dhe në provat e administruara njësitë emergjente kanë dalë në teren të cilët janë munduar ta shuajnë zjarrin, por ka qenë e kotë. Nga shkresa e PTH në Pejë konkretisht aktvendimi PPP.II. nr. 954/16 i dt. 18.06.2019, vërehet se është iniciuar kallëzim penal ndaj personit N.N., për kryerjen e veprës penale “Zjarrëvënie” nga neni 34. Po ashtu në këtë vendim vërehet se PTH, në Pejë ka autorizuar Policinë e Kosovës, për ndërmarrjen e veprimeve hetimore për zbardhjen e këtij rasti. Njëra ndër provat që është dashur te nxirren nga Policia e Kosovës, konkretisht Njësi i Forenzikës, ka qenë dhe ekspertiza e cila do të mund të vërtetonte shkakun e zjarrit, veprim të cilin nuk e kanë ndërmarrë. Me anë të ekspertizës së vlerësimit të pronës është vërtetuar se paditësve me rastin e djegies se shtëpisë dhe orëndive brenda saj iu është shkaktuar dëm në lartësi prej 98,000 euro. Me anë të ekspertizës nga lëmia e mjekësisë, konkretisht ortopedisë dhe neuropsikiatrisë, është vërtetuar se paditësja Z në natën kritike ka pësuar lëndime trupore dhe frikë të intensitetit primar dhe sekondar. Në lidhje me këtë çështje me anë të parashtrimit të padisë, gjykatës i është bërë me dije se në GJTH në Peje, në lidhje me çështje të ngjashme është vendosur me dy aktgjykime konkretisht me aktgjykim C.nr. 77/16 i dt. 12.02.2018 i GJTH-Pejë dega në Istog dhe C. Nr. 209/17 i dt. 22.10.2018 i GJTH në Peje. Sipas ligjit për Policinë konkretisht neni 10 policia e Kosovës ka për obligim që qytetarëve tu ofrojë siguri në zhvillimin dhe mbarëvajtjen e jetesës se tyre. Me siguri këtu është nënkuptuar që policia e Kosovës duhet të ndërmarrë të gjitha veprimet hetimore për zbardhjen dhe gjetjen e shakatarit në rastet kur kemi të bëjmë me djegie të shtëpisë apo objekteve të tjera. Andaj duke i pasur parasysh të cekurat si me lartë, gjykatës i propozojmë që të aprovojë në tërësi kërkesëpadinë si në precizimin e bërë me dt. 25.01.2024, e të dorëzuar në këtë gjykatë. Po ashtu ta detyrojë të paditurën të i paguajë shpenzimet gjyqësore dhe atë: për takse gjyqësore 1,001 euro, për përpilim e padisë 487.50 euro, për seanca gjyqësore shumë 633.75 për një seancë ku për 10 seanca shumë 6, 337.50 euro, ekspertiza elektroteknike në shumë prej 300 euro, ekspertiza për vlerësim të pronës 250 euro, ekspertiza mjekësore shumë 200 euro, e në total shumë në përgjithshme prej 8, 576 euro.

Gjykata në kuptim të nenit 423 paragrafi 4 te LPK-se, e sipas propozimit të autorizuarës së paditësit, seancën e shqyrtimit kryesor te dt. 26.03.2024, e ka mbajtur në mungesë të autorizuarit të paditurës, pasi që i njëjti ishte i ftuar në mënyrë të rregullt, dhe ftesës nuk i është përgjigjur e as mungesën nuk e ka arsyetuar.

I autorizuari i të paditurës me përgjigje në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: E paditura thekson se nga procesverbali i kaluar datë 20.12.2023 shihet se lënda është në proces penal, për çka i propozon gjykatës që në pajtim me LPK të ndërpritet kjo procedurë pasi që çështja varet nga epilogu i procedurës penale, e thënë nga pala paditëse. Ekspertiza nuk ka ofruar prova në asnjë rrethanë që Policia e Kosovës do të mund të mbahet përgjegjëse për

shkaktimin e demit. Ekspertizat Mjekesor nuk janë relevante sepse mungon baza ligjore e padisë dhe kundërshtojmë në tërësi. Neni 136 Bazat e përgjegjësive, thekson se: Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, provës nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij. Kërkesa për shpërblimin e demit të shkaktuar pa vërtetuar me aktvendim penal përgjegjësia e zyrtareve policore bie ndesh me nenin 136 të LMD si me sipër. Sa I përket të Mungesës së legjitimitetit Pasiv: Nga gjendje faktike e përshkuar shihet qartë që dëmi është shkaktuar nga persona të tjerë nuk mund të sjell përgjegjësinë e MPB pasi paditësit nuk i kanë shkaktuar dëmin, dhe është jashtë kontrollit të tyre parashikimi i ngjarjeve e të së ardhmes. MPB kanë marrë të gjitha veprimet për të hetuar rastin, dhe kanë ngritur kallëzim penal, për këtë lëndë, nga provat e ofruar në këtë padi, nuk mund të shihet asnjë lëshim të policisë së Kosovës që do të mbante përgjegjës ndonjë zyrtar policor, për lëshimet e bëra gjatë hetimit të kësaj lënde, për derisa nuk dihet kryerësi i veprës penale, hipotetakisht zjarr vënia në pronën e paditësit mund të jetë aksidentale ose vetë e shkaktuar, prandaj derisa nuk vërtetohet përgjegjësia penale e kryerësit të kësaj vepre, atëherë nuk mund të kërkohet dëmi nga MPB- P. e Kosovës sepse nuk mund të nisemi nga baza e parashikimeve se çka do të ndodhë në çdo pronë të qytetarëve. Në raste tjera ngjashme Gjykatat i Refuzojnë Paditë sepse Polica nuk është përgjegjës për këto raste, ajo ndjek procedurat sipas ligji dhe kryejnë Obligimin Pozitiv sipas Ligjit Kushtetutës dhe Konventën Evropiane për drejtat e njeriut. Në lëndë C. Nr 165/17 Gjykata Themelore në Pejë, Dega Istog në mes tjerash kishte theksuar se Lëndët e kësaj natyre që Policia kujdeset zyrtarisht dhe janë lëndë që ndiqej sipas detyrës zyrtare. Po ashtu, paditësi me asnjë provë të vetme nuk e ka dëshmuar faktin se të paditurat kanë dështuar në kryerjen e obligimeve ligjore dhe kushtetuese, në mënyrë që të njëjtat mund të shpallen përgjegjës që për shkak të neglizhencës apo mos ndërmarrjes së veprimeve të tyre, e të ketë rezultuar me dëmin që i është shkaktuar paditësit. Përgjegjësia e institucioneve Shtetërore posaçërisht të Ministrisë e Punëve të Brendshme, mund të rrjedh nëse rasti i ndodhur nuk do të trajtohej komform procedurave ligjore, e për çka në këtë rast nuk kem ndonjë vërejtje të jetë parashtruar nga paditës çoftë me punën e Policisë së Republikës së Kosovës apo të Prokurorisë Themelore në Pejë, në trajtimin e këtij rasti. Nga shkresat e lëndës rrjedh se fillimisht të jetë trajtuar rasti nga Policia e me pastaj sipas kompetencës Prokuroria e që ishin ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme me aktvendim për fillim të hetimeve, dhe pas përfundimit të hetimeve kishte rezultuar me aktvendim për pushime të hetimeve në mungesë të provave që dy personat e dyshuar të kenë kryer veprën për të cilën janë dyshuar. Në rastin konkret autorizimet e policisë janë përmbushur sepse kanë kryer obligimin pozitiv duke bërë hetimet penale, dhe deri në ditën e sotme nuk ka asnjë kërkesë për përgjegjësinë e zyrtarëve dhe nuk asnjë person nga Policia që është përgjegjës se nuk e ka kryer detyrën e vet. Për arsye se pretendimet e palëve paditëse nuk kanë bazën ligjore, kërkesa për shpërblimin e demit të shkaktuar nga MPB tërheq përgjegjësinë penale, i cili e ka shkaktuar dëmin, pra ju mungon Legjitimiteti real pasiv si pala e paditur. Prandaj e paditura duke u bazuar në thëniet e lartpërmendura Gjykatës propozon që të merr Aktgjykim: Refuzohet padia dhe kërkesëpadia e paditësve si e bazuar dhe Obligohen paditësve të I kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore, sipas vendimit përfundimtar të gjykatës edhe këto në afat ligjor prej 15 ditëve.

Gjykata në këtë çështje juridike – kontestimore më qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, sipas propozimit të palëve ka zhvilluar procedurën dhe ka administruar provat siç janë:

raporti i zjarrit me nr. 20/16 i lëshuar nga Z. M.M dt. 19.08.2016, kallëzimi penal nr. Rasti 2016-DA-1885 dt. 25.08.2016, Shiqohen 16 foto bardh e zi, vërtetimi i qëndrimit të rehabilitimit dt. 13.11.2016i përkthyer nga gjuha gjermane në gjuhen shqipe dt. 16.08.2019 dhe të dt. 14.11.2016 deri me dt. 27.11.2016, diagnoza e trajtimit me nr. Protokoli 35 e dt. 16.08.2019, raporti me nr. Protokoli 31 i dt. 16.08.2019, anamneza për Z.G, pasqyra e medikamenteve për Z.G me nr. Protokoli: 30 e dt. 16.09.2019, Shiqohen dy foto te ultrazërit për Z.G, ekspertiza e dt. 20.08.2021 nga lëmia e elektroteknikes, ekspertiza për vlerësimin e pronës nga H.M dt. 28.07.2022, ekspertiza mjekësore e punuar nga DR. Mithat Bala dhe Nazmi Morina, Aktvendimi PPP.II. nr. 954/16 i dt. 18.06.2019, nga PTH-Pejë dhe deklaratimet e të autorizuarve të palëve ndërgjyqës.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç, dhe të gjitha së bashku në lidhmëni me njëra tjetrën, e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata erdhi në përfundim se në këtë çështje juridiko – kontestimore duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se me datë 18.08.2016, paditësve i është djegur shtëpia me të gjitha orenditë dhe gjerat personale të palëve paditëse e cila u vërtetua edhe nga raporti me numër 16-20/16 i datës 19.08.2016 i lëshuar nga drejtoria komunale e mbrojtjes dhe shpëtimit.

Nga kallëzimi penal i paraqitur nga Stacioni Policor në Pejë me numër të rastit 2016-DA-1885 i datës 25.08.2016, gjykata vërtetoi se policia me këtë rast, kishte paraqitur kallëzim kundër NN personit-ave, për shkak se ekziston dyshimi i bazuar se persona të panjohur kanë kryer veprën penale “zjarrvënie” e sanksionuar sipas nenit 334 të KPRK-së. Nga ajo që është përshkruar në kallëzim penal, shihet se policinë e ka njoftuar pikërisht këtu paditësja e dytë Z.G duke përshkruar rastin se si ka ardhur deri tek zjarri në shtëpinë e tyre.

Nga fotot e bashkangjitura në shkresa të lëndës vërtetohet se shtëpia është djegur në tërësi ku në bazë të fotove vërehen edhe orenditë të cilat kanë qenë në shtëpi të djeguara.

Këtyre provave të administruara si më lartë, gjykata u ka falur në tërësi besimin, pasi që të njëjtat paraqesin dokumente zyrtare, përkatësisht veprime hetimore të ndërmarra nga ana e organeve të rendit, të cilat e pasqyrojnë gjendjen se si ka ndodhur rasti dhe veprimet që janë ndërmarrë.

Gjykata duke u bazuar në propozimin e të autorizuarit të paditësve me aktvendimin e datës 29.06.2021 kishte aprovuar propozimin që të mirët prova me ekspertizë nga lëmia e Elektroteknikës ku për ekspert kishte caktuar M. Shi cili në ekspertizën e tij të përpiluar me shkrim në gusht 2021 kishte konstatuar se: Në bazë të gjitha shkresave të lëndës, nga padia e përfaqësuesi të saj, raporteve të kundërshtimit të KEDS-it, raportit të policisë. raportit të Mbrojtjes dhe shpëtimit të zjarrit unë si ekspert e shprehi mendimin si në vijim: Me rastin e incizimit tim këtë objekt të djegur me datën 28.07.2021 e shoh një objekt tërësisht të riparuar që nuk ka mundësi që asnjë gjurmë të vetme të hulumtoj shkakun e shpërthimit të zjarrit nga ana e

elektrikes meqë ka kaluar një kohë e gjatë dhe objekti është tërësisht i rinovuar. Në bazë të dhënave nga AMR e KEDS-it nuk ka luajtje të tensionit për ditën e paraqitur të zjarrit në atë shtëpi. Në bazë të raportit të policisë së Kosovës me numër nr. 2016-DA-185 të datës 25.08.2016 shpërthimi i zjarrit dyshohet të jetë nga faktori i jashtëm po ashtu edhe nga Drejtoria për Shpëtim dhe Emergjente dyshimi i shpërthimit të zjarrit është nga faktorët e jashtëm (zjarrë vënje).

Gjykata i fali besimin ekspertizës së ekspertit nga lëmia e elektros pasi që e njëjta ishte punuar në mënyrë profesionale dhe gjithashtu është në harmoni edhe me shkresat tjera të lëndës dhe gjithashtu pas pranimit të ekspertizës palët ndërgjyqës nuk kishin vërejtje në të njëjtën.

Gjithashtu sipas propozimit të palës paditëse gjykata kishte marr provën me ekspertizë për vlerësimin e paluajtshmërisë ku për ekspert kishte caktuar ekspertin H.M i cili në ekspertizën e datës 28.07.2022, kishte konstatuar se: Pas Inspektimit që isha në vend të ngjarjes dhe vizitova Shtëpinë e ndërtuar ku u vërejt qartazi se Materiali i vendosur në këtë Shtëpi ishte Material i klasës së parë, ku do e specifikoj dhe këto thënje të lartshënuara mund të konstatoj edhe me anë të fotove të Shtëpisë si nga jashtë ashtu edhe nga brenda që ishte një Ndërtim i kualitetit të lartë ku shihet edhe Muri i murosur me gurë i cili ndërtim është i kushtueshëm, por në këtë rast unë nuk do veçoj vetëm murin, fasadimin, rrymën, ujin keramikët e të tërë punën e cila është bërë, por do i rumbullakësoj të gjitha dhe do të orientohem se sa ka kushtuar ndërtimi i kësaj Shtëpie Për të bërë vlerësimin e kostos në këtë kohë ku secili prej nesh e din dhe e kupton që tani materiali ndërtimor e pothuajse tërë materiali është ngritur me çmime mbi 100%, çmimin të cilin do e përcaktoj unë është çmimi para kësaj ngritje të çmimeve marramendëse (luftës në Ukrainë) dhe në kohën e ngritjes së Shtëpisë e jo në momentin e daljes në teren. 1 m². Por ne Ekspertet llogarisim edhe materialin me të cilin është punuar Shtëpia në fjalë, varet se çfarë materiali dhe duke filluar nga HidroiOlimet, Energji Aefiqente, termo dhe sistemi i dritareve, nxemja nën dysheme apo radiator, pullazin e rrafshët apo i pjerrët me nënkulëm apo i thjesht, koha e ndërtimit me amortizim, ku sa i përket çmimit asnjëherë nuk mund të konkludojmë se çmimi i kostos është i njëjtë për ndërtimin e ndonjë shtëpie por varet shumë prej faktorëve të sipërpërmendur, ku tani çmimi për 1 m² sillet nga 250 deri 400 € për m². Meqë tani edhe sa i përket mjeshhtërisë apo punimeve janë ngritur çmimet dhe asnjëherë nuk janë çmimet e njëjta ku varet se çfarë materiali ka Shtëpia që nga themeli gjerë në pullaz dhe çfarë rregullimi të mbrendshëm ka shtëpia ku i kam paraqitur në raportin tim fotot e dhomave e që është një rregullim i mirë, ku qartazi tregojnë fotot se çfarë rregullimesh ka Shtëpia. Pra meqë janë ngritur të gjitha çmimet unë nuk do të ndryshoj çmimet në atë masë sa është ngritur materiali, meqë Shtëpia është e ndërtuar para se të bëhet ngritja e çmimeve, që do të thotë e rëndësishme është që Shtëpia është ndërtuar para shtratimeve të vitit të fundit, e që unë kam ardhur në një përfundim se çmimi për 1 m² është 280 € për m² e që për mendimin tim është çmim real dhe i arsyeshëm për Shtëpinë e ndërtuar në fjalë. Andaj 350 m² x 280 = 98.000.00 euro.

Gjykata i fali besimin e ekspertizës së ekspertit për vlerësimin e pronës ku i njëjti kishte sqaruar në mënyrë profesionale mendimin e tij dhe duke përdorur edhe aspektin krahasues dhe në bazë të këtyre rrethanave dhe provave të cilat ishin në shkresa të lëndës kishte ardhur në përfundim për vlerën e objektit të djegur për çka për gjykatën sqarimet e dhëna nga ana e ekspertit në ekspertizë ishin bindëse dhe të njëjtës i fali besimin.

Pasi që paditësja e dytë kishte pësuar lëndime trupore si pasojë zjarrit sipas propozimit të autorizuarit të saj është marr prova me ekspertizë mjekësore, ku për ekspert gjykata kishte caktuar Mithat Bala, Neuropsikiatër dhe Nazmi Morina, Ortoped ku të njëjtit në ekspertizën e shkruar në të cilën kërkohet ekspertimi mjekësor nga lëmia e ortopedisë dhe neuropsikiatrisë, me anë të të cilave do të kuptohen lëndimet që i ka pësuar Z.G me rastin e shpëtimit ose ikjes nga djegja e shtëpisë kishin konstatuar se: Ngjarja kritike ka ndodhë me dt. 18.08.2016. kur është kapluar nga zjarri shtëpia, që vinte nga faktor të jashtëm - sipas ekspertizës. Ishte në trajtim në Kneiphof prej dt. 14.11.2016, deri me 27.11.2016, për shkak të dg. Stenoze e anës së djathtë e theksuar L4/LS dhe L5/S1. Ostehondroze e përparuar. Lumboischialgia kronike e djathtë, mosfunksionim i sindromit sensomotorik L5 djathtas. Operimi i kryer me dt. 04.11.2016: Dekompresim mikrokirurgjikal L4-S1. Spondylodesis L4-S1 me fiksator të brendshëm të pasëm. Sëmundjet përcjellëse janë reuma, hipertensioni dhe ndërhyrja në gju të majtë para disa vite. Nënshkruar nga terapeuti Ruppert Sabrina. Raporti i Dr med. Christian Baerlocher, specialist për neurokirurgji - përkon me ato të terapeutes të përshkruara më lartë përveç datës së pranimit që është 11.11.2016. Ky është i tërë dokumentacioni mjekësor prezent në shkresë të lëndës me të cilin disponojmë. Pas vizitës ortopedike të pacientes në lokalet e ambulantës ortopedike, me dt. 09.08.2022 ,anamnezës së deklaruar dhe të intervistimit psikaitrik kuptojmë që në ditën kritike pacientja deklaron që gjatë ikjes për të shpëtuar nga zjarri ka kapërcyer murin e oborrit përreth shtëpisë dhe ka rënë nga lartësia prej 2-3 metra në tokë. Me këtë rast është ngritë në këmbë dhe ka vazhduar të shpëtoj hallën e saj afër 60 vjeç, vajzën e saj me dy fëmijë të vegjël, një vit e gjysmë dhe 6 muaj. Pasi i shpëton ata, fillon të ndjejë dhembje të forta në regjionin e poshtëm shpindor dhe ka kërkuar ndihmë në QKMF në Deçan. Aty pohon të ketë marrë amp. Diklofen IM. Për këto nuk disponojmë më dokument mjekësor përkatës. Po ashtu nuk prezantohen raporte tjera kontrolluese për menaxhimin e mëtutjeshëm të këtij lëndimi të deklaruar. Nga këto vlenë të përmendet që në raportin e neurokirurgut kur është përshkruar historia e sëmundjes se dhembjet kanë filluar përnjëherë para 2 muaj e gjysmë. Ky është i vetmi fakt që deri diku na lidhë me datën e ngjarjes së përshkruar nga ana e paditëses, lidhur me lëndimin e përjetuar. Mbesim me shpresë që të gjenden faktet mjekësore dhe atë raporti nga QKMF në Deçan. Shpresojmë që të qartësohet shkaku që çoi në ndërhyrje kirurgjikale se a ishte akute apo kronike dhe e planifikuar. Nga dokumentacioni mjekësor prezent kuptojmë që diagnozat janë kronike kurse lëndimi ka mund ti përkeqësoj të njëjtat. Nëse vërtetohet lidhja kauzale në mes të lëndimit të përjetuar në shtëpi, në ngjarjen kritike, raporti i mjekut nga QKMF në Deçan dhe të operimit atëherë në mënyrë konsiliare deklarojmë që: Këto lëndime kualifikohen si lëndime të lehta trupore, pa përqindje të invaliditetit. Ka përjetuar dhembje me intensitet posaçërisht të lartë gjatë 1 minute. Ka përjetuar dhe dhembje të intensitetit të lartë gjatë 2 ore, gjë e cila i referohet kohës prej përjetimit të lëndimeve trupore, transportit gjerë në emergjencën e QKMF në Deçan, përpunimit diagnostik dhe të ndikimit të analgjetikut - ilaçit kundër dhembjes, konkretisht të amp. Diklofen. Dhembje të intensitetit të mesëm ka përjetuar gjatë 2 jave. Dhembje të intensitetit të ulët përjeton akoma herë pas herë dhe atë gjatë sforcimeve fizike, ecjes së gjatë, ndryshimit të motit e të ngjashme. Ndihma dhe kujdesi i huaj nuk ka qenë i nevojshëm, në kohëzgjatje prej dy jave. Ushqimi i përforcuar me vitamine, proteina dhe minerale po ashtu ishte i nevojshëm në kohëzgjatje prej dy jave. Terapia fizikale ka qenë e domosdoshme në mënyrë ambulatorike apo spitalore, në ndonjë qendër për rehabilitim, dhe atë dy herë në vit gjate 15 dite në vitin e parë.

Shëmtimi është i shkallës së ulët, vrage postoperative në regjionin e poshtëm shpindor, me gjatësi prej 7 cm. E lënduara ka përjetuar dhe frikë parësore gjatë aksidentit, me të cilën nënkuptojmë ndjenjën e rrezikut për jetë. Kjo frikë ka zgjate 5 minuta që nënkupton kohën nga përjetimi i rrezikut për jetë dhe deri në ofrimin e ndihmës së parë nga persona të tjerë. Paditësja ka përjetuar dhe frikë dytësore e cila lajmërohet për shkak të vetë natyrës së lëndimeve trupore dhe ka të bëjë me rrethana të brengosjes lidhur me shërimin, pasojat eventuale nga lëndimet e përjetuara si dhe të procedurave diagnostike e shëruese, intervenimi kirurgjik dhe rehabilitimi që i është nënshtruar paditësja gjatë kësaj faze. Kjo frikë dytësore kishte intensitet të lartë gjatë dy orëve, intensitet të mesëm gjatë 15 dite dhe intensitet të ulët, tani në formë të brengosjes, gjatë 2 muaj dhe herë pas here edhe më tej posaçërisht të shkaktuar nga dhembjet në shpinë në sforcime fizike, ecjes së gjatë, ndryshime klimatike e të ngjashme.

Gjykata i fali besimin ekspertizës mjekësor pasi që e njëjta është në harmoni edhe me raportet mjekësore të cilat gjinden në shkresa të lëndës për paditësen e dytë dhe pas sqarimit të dhënë nga eksperti i Ortopedisë në datën 25.01.2024, palët nuk kanë pasur vërejtje.

Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) 04/L-077, rregullon çështjen e kompensimit të dëmit (material dhe jo material). Me nenin 136 par.1 të LMD-së parashihet se *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*. Me nenin 137 të LMD-së përcaktohet se: *Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material). Kurse me dispozitën e nenit 183 par. 1 e LMD-së përcaktohet se Për dhembjet e pësuar fizike, për dhembjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material. Sa i përket çështjes së dëmit material të pësuar, me nenin 169 të LMD-së par. “1. Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi” dhe “4. Gjykata do t'i gjykojë të dëmtuarit shpërblimin në të holla kur ai këtë e kërkon, me përjashtim kur rrethanat e rastit konkret e arsyetojnë rivendosjen e gjendjes së mëparshme.”*

Me nenin 161 të LMD-së parashihet situata se kur shteti mban përgjegjësi për dëmet e shkaktuara nga personat e tjerë, *“Shteti ose personi që është dashur të parandalojë këtë sipas dispozitave në fuqi, është përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga vdekja ose lëndimi fizik si rezultat i akteve të terrorizmit ose gjatë demonstratave dhe manifestimeve publike.”*

Ligji Nr. 04/L-076 Për Policinë - Neni 10 parasheh Detyrat dhe autorizimet e përgjithshme të policisë 1. *Detyrat e përgjithshme të policisë janë të: 1.1. mbrojtjetën, pronën dhe të ofroj siguri për të gjithë personat.*

Neni 128 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës parasheh se “ [Policia e Kosovës] 1. *“Policia e Republikës së Kosovës mban përgjegjësinë për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike në tërë territorin e Republikës së Kosovës.”*

Neni 125 “[Parimet e Përgjithshme] 1. *“Republika e Kosovës ka pushtet mbi zbatimin e ligjit, sigurinë, drejtësinë, sigurinë publike, inteligjencën, organet civile emergjente dhe mbi kontrollin e kufijve në territorin e vet. 2. Institucionet e sigurisë në Republikën e Kosovës mbrojnë sigurinë publike dhe të drejtat e të gjithëve në Republikën e Kosovës”.*

Gjykata me rastin e vlerësimit të pretendimeve të palës paditëse, ku ka theksuar se të paditurat mbajnë përgjegjësinë për sigurinë e jetës së qytetarëve dhe pronës së tyre, kjo nuk do të thotë se të paditurat në këtë rast mbajnë përgjegjësi për dëmin që u është shkaktuar këtu palës paditëse.

Së këndejmi, lidhur me përgjegjësinë që do të mund ti mveshej në këtë rast të paditurës Ministrisë së Punëve të Brendshme, Gjykata thekson se një gjë e tillë do të mund të vinte në shprehje, në dy situata: Situata e parë është sikur organet e rendit fillimisht do të ishin të informuara për sulme të mundshme, qoftë për jetën e tyre apo pronën e paditësve, ose nëse do të kishte pasur informata se paditësve u kanosej ndonjë sulm nga ndonjë person ose tjetër e që e paditura me këtë rast nuk do të kishte ndërmarrë masa mbrojtëse apo parandaluese, dhe situata e dytë është nëse e paditura, nuk do të kishte ndërmarrë asnjë veprim lidhur me zhvillimin e hetimeve lidhur me rastin e ndodhur.

Lidhur me situatën e parë, gjykata thekson se organet e rendit, në këtë Rast Policia nuk kishte asnjë informatë paraprake se palës paditëse u është rrezikuar jeta e tyre apo prona. Ku palët paditëse nuk kishin paraqitur asnjë provë për të argumentuar këtë rrethanë. Në rastin që palët kishin shfaqur dyshime, policia dhe prokuroria kishin ndërmarrë veprime në këtë drejtim, e që është pasi që ka ndodhur rasti. Paditësit, paraprakisht nuk kishin kërkuar asnjë lloj ndihme nga organet e rendit, e që shteti të ketë dështuar që ju ofrojë ndihmë paditësve.

Situata e dytë është nëse shteti, nuk do të kishte ndërmarrë asnjë veprim në drejtim të zbulimit të kryesve të veprës penale, me të cilën paditësve u është shkaktuar dëm. Nga provat e administruara si më lartë, Policia e Kosovës, kishte ndërmarrë veprime hetimorë, kishte dalë në vendngjarje dhe si përfundim kishte paraqitur Kallëzim Penal. Sa i përket Komunës, e njëjta përmes ekipit të emergjencës, i ishte paraqitur thirrjes së paditësve ku kishte dalë me ekipin e saj dhe kishte ndalur zjarrin. Më pas, kishin përpiluar një raport të veçantë mbi rastin, duke konstatuar dhe shkaktarin e zjarrit. Pra organet e rendit, nuk kanë qëndruar duarkryq.

Edhe pse me këtë rast ka dispozita materiale që e rregullojnë këtë çështje, gjykata thekson se në bazë të Aktgjykimit KI41/12 dt.26.02.2013 nr. REFAGJ361/13 të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, që është një rast që ka të bëjë kur shteti ka dështuar që ti ofrojë mbrojtje qytetarit, kur i njëjti ka kërkuar ndihmë, ky aktgjykim në mënyrë të tërthortë cekë situatën se si shteti nuk mund të mbahet përgjegjës, nëse qytetari i vendit nuk ka kërkuar ndihmë paraprakisht, me çka organet e rendit do të kishte vënë në dijeni për një rrezik të mundshëm. Ndër të tjera, në këtë

aktgjykim theksohet se, për t'u ngritur një detyrim pozitiv, duhet të vërtetohet nëse autoritetet kanë ditur apo është dashur të dijnë në kohën e ekzistimit të një rreziku real dhe të menjëhershëm, për jetën e një individi të identifikuar nga veprat kriminale të një palë të tretë dhe që kanë dështuar të ndërmarrin masa brenda fushëveprimit të kompetencave të tyre, gjykuar arsyeshëm, do të mund të pritej ta mënjanonin atë rrezik. Në kuptim të kësaj, nga ajo që është provuar në këtë gjykim, ndërgjygjësit asnjëherë nuk kishin paralajmëruar shtetin më ndonjë rrezik potencial të mundshëm të paktën nuk kanë parashtruar dëshmi për të argumentuar të kundërtën. Në këtë rast e paditura nuk ka ditur e as që kanë mundur të dijë për ndonjë sulm apo rrezik të mundshëm që ju ka kanosur paditësve. Paditësit, për më tepër nuk kanë shfaqur asnjë dyshim tek ndonjë person, jo para ndodhjes së rastit por as pas ndodhjes. Dyshimet e tyre të mëvonshme lidhur me një person të tretë, kanë mbetur vetëm në atë nivel, ku policia ka bërë e ka proceduar rastin me anë të kallëzimit penal në prokurorin Themelore në Pejë, e ku Gjykata i është drejtuar prokurorisë për të kërkuar informata lidhur me këtë rast dhe e njëjta ka njoftuar gjykatën se kallëzimi penal është hedhur ndaj personit N/N ku si dëshmi ka bashkangjitur edhe Aktvendimin me numër PPP/II. Nr. 954/16 të datës 18.06.2019.

Pavarësisht kësaj, pak a shumë një situatë e njëjtë me një rast të ngjashëm, lidhur me detyrimin e shtetit për të ofruar siguri tek qytetarët, parashihet edhe tek rasti *Osman vs United Kingdom* ku Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka theksuar “personi që pretendon se i është cenuar e drejta në jetë, duhet të dëshmojë se autoriteti e ka ditur ose është dashur ta dijë në atë kohë për ekzistimin e një rreziku real dhe të menjëhershëm të një palë të tretë, dhe ka dështuar të ndërmarrë masat brenda fushëveprimit të fuqive të tij, që të gjykuara arsyeshëm, mund të jenë pritur ta kenë parandaluar atë rrezik. Pra shteti ka obligim të veprojë kur kushtet e paracaktuara dëshmojnë nga personi, në të kundërtën, cilësohet se i'a ka cenuar personit të drejtën në jetë”.

Gjykata rithekson, edhe pse rasti i mësipërm ka të bëjë me të drejtën në jetë, në këtë rast mund të aplikohet standardi i njëjtë, ashtu që duke tërhequr paralelen e njëjtë mund të konkludojmë: pala paditëse ka dështuar të dëshmojë se shteti ka ditur ose është dashur të dijë për ekzistimin e një rreziku real dhe të menjëhershëm të një palë të tretë, ashtu që shteti më pas të ketë dështuar që të ndërmarrë masat brenda kompetencave të tij, e të cilat do të kenë mundur që të parandalojnë rrezikun. Pra vendimtare në këtë rast është paraqitur fakti nëse paditësit i kanë njoftuar të paditurën për ndonjë sulm të mundshëm, e që e njëjta më pas të ketë dështuar që të i ofrojnë mbrojtje palës paditëse. Ajo që ka qenë shumë më rëndësi, është edhe fakti tjetër se pikërisht paditësit nuk kanë shfaqur asnjë dyshim tek asnjë person, pra provohet edhe fakti se i njëjti nuk ka pasur asnjë dyshim te ndonjë person që të mund të ofroj dëshmi organeve kompetente, andaj në këtë situatë, si mund të mbahet përgjegjëse e paditura? Veprimet e mëtutjeshme pas ndodhjes së rastit, vërtetojnë se të paditura, në kapacitetet e veta i është përgjigjur thirrjes dhe ka ndërmarrë veprime konkrete në zbulim të kryesve.

Gjithashtu sa i përket dëmeve në automjetin Për djegëjen e veturës të markës Ford tipit Galaxy me targa SG – 436686, të shtetit të Zvicrës, palët paditëse nuk kanë ofruar asnjë dëshmi lidhur me këtë automjet se ne pronësi të kujt është apo se çfarë ka ndodh me të njëjtin pasi që palët paditëse i referohen vetëm në aspektin deklarativ por jo duke i bazuar këto deklaratime në prova.

Gjykata thekson se palët paditëse kanë dështuar që të argumentoj faktin se dëmi është ardhë si pasojë e të paditurës edhe pse kjo ka qenë detyrë e tyre, në kuptim të nenit 322 paragraf 1 dhe 2 e lidhur me neni 7 paragraf 1 dhe 319 paragraf 1 të LPK-së, e në anën tjetër gjykatës i ka munguar autorizimi që të nxjerr prova sipas detyrës zyrtare sepse me nenin 7 paragraf 2 të LPK-së, përcaktohet se: “ *Gjykata mund të kërkoj nxjerrjen e provave sipas detyrës zyrtare, për vërtetimin e fakteve edhe pse palët nuk i kanë propozuar, vetëm nëse ato prova po që se nga rezultati i shqyrtimit dhe i të provuarit del se palët kanë për qëllim disponimin me kërkesat me të cilat nuk mund të disponojnë lirisht të përcaktuara në kuptim të nenit 3 paragraf 3 të LPK-së*”.

Pretendimet e palës paditëse, se e paditura mbanë përgjegjësi për dëmin që u është shkaktuar paditësve, për shkak se në kuadrin e autorizimeve të saj është fusha e sigurisë dhe mbrojtjes së jetës së qytetarë, gjykata e mori si të pabazuar këtë pretendim, pasi që është fakt i pakontestueshëm që Policia e Kosovës në kuadrin e detyrave të saj ka fushën e sigurisë, mirëpo këto kompetenca shtrihen në drejtim të veprimeve të tyre të përditshme për kapjen e kryesve të veprave penale por edhe parandalimin e veprave, por kur janë në dijeni se vepra penale pritet të ndodhë. Për më tepër, policia pas rastit ka ndërmarrë të gjitha veprimet që ka pasë në autorizimet e saja.

Në këtë kuptim, dispozitat materiale të cekura si më lartë, ato të Ligjit për Policinë dhe të Kushtetutës, janë dispozita autorizuese, të cilat Policisë dhe të paditurave, u japin kompetenca për zhvilluar aktivitetin e tyre, i cili buron nga Kushtetuta e vendit. Këto dispozita, nuk janë të atilla mbi të cilat mund mvishet barra e përgjegjësisë, sepse baza e kompensimit të dëmit është pikërisht tek LMD, ku ashtu siç përcaktohet në nenin 161 të LMD-së, çartazi parashihet kur shteti mbanë përgjegjësi. Në këtë kuptim, pavarësisht faktit se e paditura mban përgjegjësinë për jetën dhe sigurinë e qytetarëve dhe pronës së tyre, ajo nuk ka dështuar që të ofrojë siguri në këtë drejtim, sa i përket mbrojtjes së pronës së paditësve.

Gjykata thekson, se dispozitat ligjore materiale, në këtë rast ato nga LMD lidhur me përgjegjësinë e dëmit, në asnjë mënyrë nuk mund të aplikohen tek e paditura, sepse dëmi që ju është shkaktuar paditëseve, nuk është shkaktuar me fajin e të paditurës, as në mënyrë të drejtpërdrejtë e as indirekte.

Si përfundim, gjykata thekson se padisë së palës paditëse i mungoj baza juridike, pavarësisht faktit se lartësia e dëmit është provuar (dëmi material dhe jo material) dhe nuk ishte kontestuese as nga palët në procedurë shkaktimi i këtij dëmi, por kontestuese ishte në vazhdimësi baza e kërkesëpadisë, që në këtë rast pala paditëse ka dështuar që të provojë se e paditurat mbanë përgjegjësi për këtë dëmi.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata vendosi si në pikën dy të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ashtu që secila palë t’i bartë shpenzimet e procedurës, konform nenit 450, 452 dhe 463 të LPK-së, ngase pala paditëse e ka humbur kontestin ndërsa pala e paditur nuk i ka specifikuar shpenzimet procedurale, e sipas nenit 463 par. 1 të LPK-së: *Për pagimin e*

shpenzimeve procedurale gjykata vendosë vetëm me kërkesën e specifikuar të palës, pa bërë asnjë shqyrtim verbalisht lidhur me kërkesën, për çka edhe gjykata vendosi që secila palë ti bartë shpenzimet e veta procedurale.

Nga sa u tha më lartë, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke u bazuar në nenin 143.3 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2019:180743 - C.nr.1001/19, 16.04.2024**

G j y q t a r i
Besnik Shala

Këshilla juridike:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 dite, nga dita e pranimi, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykate.